

	KOMENTE	FO-ÇRT-011
	ver. 1.2	faqe 1 nga 6

28.09.2022

Komente lidhur me: Raportin Konsultativ të ZRRE-së për Faktorin e efikasitetit

Çështja për komentim:

Përgjigjet ndaj çështjeve të ngritura nga ZRRE-ja në Dokumentin Konsultativ lidhur me Faktorin e Efikasitetit

Komentimi:

1.0 HYRJE

Ky dokument paraqet përgjigjen e KOSTT-it ndaj çështjeve të ngritura nga ZRRE-ja në Raportin e saj Konsultativ në lidhje me Faktorin e Efikasitetit, të datës 13 shtator 2022.

KOSTT-i dëshiron ta falënderojë ZRRE-në për dhënien e përgjigjes ndaj çështjeve të ngritura nga KOSTT-i në Propozimin për Faktorin e Efikasitetit, të datës 29 korrik 2022.

KOSTT-i ende konsideron se rekomandimi i tij në raportin e 29 korrikut është i arsyeshëm bazuar në situatën me të cilën ballafaqohet në sektorin energjetik të Kosovës, megjithatë, ne e kuptojmë situatën e vështirë në të cilën ndodhet ZRRE-ja, duke pasur parasysh barrierat politike dhe sociale që pengojnë çmimet e bazuara në treg të kalojnë në tarifa, në kohë, tek ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla në Kosovë. Vlera e “Inflacionit të Harmonizuar të Evropës (HICP) 2022” për periudhën 12-mujore më të fundit është 9.1% dhe ajo rritet çdo muaj. Kjo vlerë është shumë më e madhe se çdo rritje e çmimeve në tregun me pakicë të dhënë ndonjëherë nga ZRRE-ja.

Meqenëse disa nga parametrat hyrës (përfshirë faktorin e efikasitetit) bazohen në të dhëna "të buta" dhe ushtrime akademike, në krahasim me të dhënat faktike (ang. *“hard data”*) specifike për Kosovën, nuk është për t'u habitur që ZRRE-ja duhet t'i përdorë ato parametra në mënyrë që të mbajë çmimet e tregut me pakicë sa më të ulëta. Nëse mendojmë për efikasitetin e prodhuesve si një mënyrë për të kompensuar pjesërisht efektet e inflacionit në energji, është e kuptueshme që ZRRE-ja është e shqetësuar për këtë parametër pasi që norma e inflacionit është 9.1% dhe ajo është në rritje.

Duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, KOSTT-i i dorëzon përgjigjet e tij për Dokumentin Konsultativ në këtë dokument.

2.0 PËRGJIGJET NDAJ ÇËSHTJEVE TË NGRITURA NGA ZRRE NË RAPORTIN KONSULTATIV

KOSTT-i vlerëson se ZRRE-ja i është përgjigjur secilës prej pikave që KOSTT-i ka ngritur në dorëzimin e tij të datës 29 korrik lidhur me Faktorin e Efikasitetit. Ne do t'i adresojmë këto përgjigje si dhe qasjet e reja që ZRRE-ja ka prezantuar në lidhje me përcaktimin e faktorit të efikasitetit.

A. Pikat për të cilat ZRRE-ja dhe KOSTT-i bien dakord

ZRRE-ja vuri në dukje se kur vendos bazën e lejuar për OPEX, ajo do të përfshijë në mënyrë specifike pesë nga çështjet e ngritura nga KOSTT-i (pikat 5 – 9), si në vijim:

- Rritjet në bazën e aseteve të KOSTT-it për të përmbushur nevojat e Kosovës për energji elektrike.
- Projekte të reja kapitale të planifikuara për 5 vitet në vijim të cilat do të rrisin kostot O&M.
- Rregulloret e reja për pajtueshmërinë me rregulloret qeveritare, standardet mjedisore dhe standardet e shëndetit dhe sigurisë rrisin kostot.
- Raporti i fundit i ENTSO-E kërkon nga KOSTT-i që ta rrisë numrin e stafit dhe t'i rrisë kostot operative, duke marrë parasysh detyrat dhe kërkesat e reja që dalin nga ENTSO-E.
- Kufizimet në rrjedhën e parasë në të kaluarën që kanë ndikuar tek KOSTT-i, duke rezultuar në anulimin ose shtyrjen e projekteve të O&M. Kriza e mëtejshme e energjisë elektrike do ta përkeqësojë situatën në KOSTT.

B. Pikat e ngritura nga KOSTT-i të cilat ZRRE-ja nuk i ka përfshirë në propozimin e saj

KOSTT-i pohon se niveli i Faktorit të Efikasitetit ishte vendosur në mënyrë arbitrare në 1.5% në rishikimet paraprake të tarifave duke përdorur një metodologji të dizajnuar kryesisht për vendet shumë të zhvilluara. Për më tepër, si kompani shtetërore, KOSTT-i nuk ka fleksibilitet të mjaftueshëm për t'i menaxhuar kostot, siç janë numri dhe paga e punëtorëve, negociimi i çmimeve me furnitorët etj. ZRRE-ja nuk i ka marrë parasysh këto pika për të arritur në qëndrimin e saj.

KOSTT-i theksoi se Faktori i Efikasitetit nuk përdoret në mënyrë të konsiderueshme në ERRRA (Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë) dhe një vlerë prej 1.5% nuk është tipike për vendet anëtare. Kjo çështje adresohet në seksionin C më poshtë.

Gjatë periudhës së mëparshme rregullatore, ka korrelacion minimal midis OPEX-it të lejuar dhe OPEX-it real.

C. Faktori i Efikasitetit nuk përdoret në mënyrë të konsiderueshme në shtetet anëtare të ERRA-së (Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë).

Në dorëzimin e tij të datës 29 korrik tek ZRRE-ja, KOSTT-i theksoi se shumica e rregullatorëve të ERRA-së **nuk** i përdorin faktorët e efikasitetit për të vendosur tarifa. Si mbështetje për këtë pohim, KOSTT-i iu referua raportit për ERRA-në të prillit të vitit 2020 nga Economic Consulting Associates, të titulluar “Qasjet rregullatore për përcaktimin e të ardhurave për Operatorët e Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”. Ky raport përmendi: “ndër Organizatat Anëtare të ERRA-së, aktualisht ka një përdorim të kufizuar të faktorëve të efikasitetit qoftë në nivelin e kontrollit të tarifave ose të të ardhurave ose në përcaktimin e lejimeve të kostos”. Nga 20 rregullatorë të përfshirë në studim, 50% (10) nuk përdorin faktorët e efikasitetit. Nga 10 rregullatorët e mbetur:

- 2 prej tyre nuk e shpalosën vlerën
- 3 prej tyre përdorin faktor prej 1%.
- 4 prej tyre përdorin faktorin prej 1.5% (përfshirë Kosovën)
- 1 prej tyre përdor 4% (Nigeria, e veçuar).

Bazuar në atë studim, KOSTT-i deklaroi se përdorimi i faktorit prej 1.5% nuk është tipik për vendet e ERRA-së. KOSTT-i pohon se kjo situatë është ende e pranishme. Në fakt, në dokumentin e saj konsultativ, ZRRE-ja deklaroi se: “...ka zbatim të kufizuar të faktorëve të efikasitetit të përdorur në vende të ndryshme”. Megjithatë, përkundër faktit se shumica e anëtarëve të ERRA-së nuk i përdorin këta faktorë, ZRRE-ja i ka paraqitur të dhënat në Tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1: Përzgjedhja e vendeve nga ana e ZRRE-së të paraqitura në raportin konsultativ

	OST	OSSH	Referenca
Austria	Varet nga kompania	1.25% - 4.4%	Baza e të dhënave e ARRE-së
Butani	2.0%	2.0%	Baza e të dhënave e ARRE-së
Republika Çeke	1.0%	1.0%	Baza e të dhënave e ARRE-së
Finlanda	2.2%	2.2%	WIK-Consult, Standardet krahasuese të kostove në rregullimin e energjisë në vendet evropiane.
Gjeorgjia	1.5%	1.5%	Baza e të dhënave e ARRE-së
Hungaria	1.5%	1.5%	Baza e të dhënave e ARRE-së
Lituania	1.0%	1.0%	Baza e të dhënave e ARRE-së
Moldavia	1.0%	1.0%	Baza e të dhënave e ARRE-së

Holanda	1.5%	1.5%	WIK-Consult, Standardet krahasuese të kostove në rregullimin e energjisë në vendet evropiane.
Nigeria	4%		Studimi i ERRA-së mbi Qasjet rregullatore të përcaktimit të të ardhurave, 2017
Irlanda veriore	0.80%	0.80%	Rregullatori i shërbimeve komunale, Efektet reale të çmimeve dhe produktiviteti RP6, Përcaktimi përfundimtar, 2017
Norvegjia	1.5%	1.5%	WIK-Consult, Standardet krahasuese të kostove në rregullimin e energjisë në vendet evropiane.
Omani	1%	1%	Studimi i ERRA-së mbi Qasjet rregullatore të përcaktimit të të ardhurave, 2017
Polonia	1.50%	1.50%	Studimi i ERRA-së mbi Qasjet rregullatore të përcaktimit të të ardhurave, 2017
Romania	1 - 1.5%	2%	Baza e të dhënave e ERRA-së
Sllovakia	3.5%	3.5%	Baza e të dhënave e ERRA-së
Turqia		1.17%	Baza e të dhënave e ERRA-së
MB	1.25%	1.25%	OFGEM - RIIO-2 Përcaktimi Përfundimtar, 2020

KOSTT-i kundërshton fuqimisht përdorimin e mostrës së mësipërme të njëanshme të 18 vendeve për t'u marrë parasysh në përcaktimin e një faktori efikasiteti për KOSTT-in. Kundërshtimet tona bazohen si në vijim:

- Gjashtë nga vendet nuk janë anëtarë të ERRA-së (Butani, Finlanda, Holanda, Irlanda Veriore, Norvegjia dhe MB-ja). Është e çuditshme që u zgjodh Butani (një vend i izoluar i Himalajeve), përveç faktit që faktori i tij prej 2% është padyshim i lartë. Pesë vendet e tjera janë vende shumë të zhvilluara në Evropën Perëndimore që nuk janë të krahasueshme me Kosovën për nga madhësia apo niveli i menaxhimit dhe ekspertizës teknike.
- 12 vendet e mbetura janë anëtarë të ERRA-së. Duke qenë se ERRA ka 34 anëtarë të plotë dhe 14 anëtarë të asociuar, kjo forcon qëndrimin e KOSTT-it se shumica e anëtarëve të plotë të ERRA-së (65%) nuk i përdorin faktorët e efikasitetit. Gjithashtu, kini parasysh se janë 14 anëtarë të asociuar që nuk janë përfshirë në tabelë.

Bazuar në faktet e mësipërme, KOSTT-i qëndron në pohimet e tij në dorëzimin e 29 korrikut se faktorët e efikasitetit nuk janë shfrytëzuar nga shumica e vendeve të rajonit.

D. ZRRE-ja prezantoi teori komplekse akademike por vendosi të mos i përdorë ato

Teoritë e faktorëve të efikasitetit u referuan në Raportin konsultues në lidhje me Efikasitetet Catch-Up (duke përdorur standarde krahasuese dhe Rrjetet e Referencës Virtuale) si dhe Efikasitetet Frontier Shift. Këto koncepte duket se vijnë nga një raport i vitit 2018 i zhvilluar nga Europe Economics për Ofwat, rregullatori i ujit dhe ujërave të zeza në Mbretërinë e Bashkuar, i titulluar "Efektet reale të çmimeve dhe Frontier shift". Pas përshkrimit të këtyre teorive komplekse, ZRRE-ja arriti në përfundimin se ato nuk ishin të zbatueshme në Kosovë. KOSTT pajtohet me këtë.

E. ZRRE-ja ka përdorur të dhënat e kontabilitetit për të tentuar të tregojë përfitimet nga efikasiteti

Meqë nuk mund të përdorej ndonjë standard krahasues (ang. *"benchmarking"*), ZRRE-ja ka shikuar kostot e përmbledhura të kontabilitetit gjatë një periudhe 5-vjeçare në lidhje me të dhënat operative (energji e transmetuar, piku koincident, gjatësia e kablove dhe kapaciteti i transformatorit). Megjithatë këto parametra operativë mund të konsiderohen përcaktues të rëndësishëm të humbjeve teknike, ata nuk janë domosdoshmërisht shtytës të kostove operative dhe të mirëmbajtjes. Nuk përmendej produktiviteti i punës, praktikat e menaxhimit të mirëmbajtjes, efikasiteti i prokurimit, përdorimi i pajisjeve, inovacionet teknike dhe të TI-së, etj. që do të nxisnin eficientësinë e kostove.

Përveç kësaj, kufizimet e parasë së gatshme kanë ndikuar tek KOSTT-i në të kaluarën, duke rezultuar në shtyrjen ose anulimin e projekteve të mirëmbajtjes. Kjo për faktin se, kur ka mungesë të parasë së gatshme, mirëmbajtja është komponenti kryesor i OPEX që reduktohet. Shumica e kostove të tjera operative nuk mund të reduktohen pasi sistemi duhet të jetë në funksion. Megjithatë ndikimi i reduktimeve të kostove të mirëmbajtjes ndihet kryesisht në të ardhmen, vendimi i vështirë është shtyrja e projekteve. Sigurisht, shtyrja e mirëmbajtjes nuk është praktikë e kujdesshme menaxhimi dhe përfundimisht do të ndikojë në nivelet e shërbimit dhe do të rezultojë në kosto më të larta në të ardhmen nëse pajisjet dështojnë para kohe.

F. Rruga e propozuar nga KOSTT-i për më tutje

KOSTT-i ende konsideron se rekomandimi i tij në raportin e 29 korrikut që faktori i efikasitetit të vendoset në zero është i arsyeshëm bazuar në situatën me të cilën ai ballafaqohet në sektorin energjetik të Kosovës. Materiali në këtë raport konfirmon më tej atë rekomandim.

Ne jemi të vetëdijshëm, megjithatë, se barrierat politike dhe sociale e pengojnë ZRRE-në që t'i kalojë çmimet e bazuara në treg në tarifa, në kohë, për ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla në Kosovë. Vlera e "Inflacionit të Harmonizuar të Evropës (HICP) 2022" për periudhën 12-mujore më të fundit është 9.1% dhe ajo rritet çdo muaj. Kjo vlerë është shumë më e madhe se çdo rritje e çmimeve në tregun me pakicë të dhënë ndonjëherë nga ZRRE-ja.

Siç është diskutuar këtu, Faktori i Efikasitetit është përcaktuar në bazë të të dhënave "të buta" dhe ushtrimeve akademike, në krahasim me të dhënat faktike specifike për Kosovën. Qëndrimi i ZRRE-së në Dokumentin Konsultativ është që faktori i efikasitetit të vendoset në 1.5% deri në 2%. Vlera 2% definitivisht nuk mbështetet në asnjë bazë racionale. Rritja e faktorit nga niveli

aktual prej 1.5% do të ishte thjesht një përpjekje arbitrare për të ulur nivelin e të hyrave të lejuara në kurriz të KOSTT-it.